

Ç'KA ËSHTE PËRFAQËSIMI GJYQËSOR I TË RRITURVE?

Një person me moshë ligjore (i rritur) mund të ketë kufizime, për shkak të një sëmundjeje mendore apo një sëmundjeje të krahasueshme, në aftësinë e tij vendimmarrëse dhe nuk mund të jetë më në gjendje të kujdeset për çështje të caktuara pa rrezik e vuajtje apo disavantazh për vetveten. Në këtë rast, ai ose ajo mund të përfaqësohet nga një përfaqësues ose një përfaqësuese përkatës për të rriturit (Erwachsenenvertreter). Ky përfaqësues emërohet nga gjykata vetëm nëse personi i rritur në fjalë nuk ka autorizim, nuk është në gjendje të zgjedhë vetë një përfaqësues, nuk ka mbështetje nga persona të ngushtë, si të afërmit mbasi nga rrethanat e vështira të jetesës e bëjnë këtë zgjidhje të nevojshme. Emërimi i përfaqësuesit ligjor të të rriturve ose përfaqësueses ligjore e të rriturve nuk kufizon automatikisht aftësinë ligjore të individit për të vepruar, pa marrë parasysh nëse nga gjykata emërohet një përfaqësues, e cila do të thotë që alternativat për mbështetje duhet të vazhdojnë të kërkohen.

Kush jemi ne?

Shoqata VertretungsNetz mbron të drejtat themelore të njerëzve me sëmundje mendore ose dëmtim intelektual. Punonjësit e VertretungsNetz mbështesin dhe këshillojnë të prekurit dhe të afërmit e tyre në çështjet që kanë të bëjnë me përfaqësimin, por edhe në rastet e vendosjes së detyruar ose kufizimeve në lirinë e spitaleve, shtëpive të pleqve, objekteve për fëmijë dhe të rinjve ose objekteve për personat me aftësi të kufizuara. VertretungsNetz vepron në zyrat në të gjitha shtetet federale përveç Vorarlberg, është jo-partiake dhe jo-fitimprurëse dhe punon në emër të Ministrisë së Drejtësisë.

Çfarë ofrojmë ne?

Ne ofrojmë këshilla edhe për ata që kanë nevojë për një përfaqësues, ashtu edhe për të afërmit e tyre. Ne gjithashtu trajnojmë ata që duan të përfaqësojnë një person të ngushtë ose tashmë kanë filluar ta bëjnë këtë. Përveç kësaj, ne përfaqësojmë njerëzit me aftësi të kufizuara vendimmarrëse si përfaqësues të emëruar nga gjykata. Gjykata përcakton çështjet në të cilat përfaqësojmë klientët tanë, p.sh. në përfaqësimin e tyre para autoriteteve specifike, në lidhjen e kontratave, në rregullimin e financave të tyre ose në sigurimin e vendbainimit të përshtatshëm.

- VertretungsNetz – Erwachsenenvertretung, Patientenanwaltschaft, Bewohnervertretung
- Zentrum Rennweg, Ungargasse 66/2/3. OG, 1030 Wien
- T 01/ 330 46 00, F 01/ 330 46 00-99
- verein@vertretungsnetz.at • www.vertretungsnetz.at
- Vereinssitz: Wien, ZVR: 409593435

Para se një gjykatë të caktojë një përfaqësues, ne sqarojmë në emër të gjykatës nëse ekziston ndonjë mundësi tjetër ku individi i përfaqësuar mund të arrijë një nivel më të lartë të vetëvendosjes. Ligji i ri për Mbrojtjen e të Drejtave parashikon tri opsione të tjera për përfaqësim: Autorizimin, Përfaqësimin e Zgjedhur dhe atë Ligjor për të rritur. Nëse mbështetja përfitohet nga mjedisi personal, si nga familja apo shërbimet psiko-sociale, atëherë nevoja për një përfaqësues të caktuar nga gjykata mund të eliminohet plotësisht.

Si vjen deri te një përfaqësim gjyqësor për të rritur? Si shkon procedura ligjore (gjygsore)?

1. Në kuadër të të ashtuquajturit '**Clearing**', VertretungsNetz si një shoqatë për mbrojtjen e të rriturve percakton (studion) situatën e jetesës së individit në fjalë. Cilat çështje specifike duhet të trajtohen dhe cilat rreziqe mund të identifikohen? Ku është e nevojshme ti ofrohet ndihmë që individi në fjalë të ketë aftësinë për të vetvepruar sipas të drejtave të tyre ligjore? A ofron mjedisi shoqëror apo institucionet, autoritetet apo shoqatat mundësi për mbështetje? Qëllimi, është që të shmangët një përfaqësim i caktuar nga gjykata dhe të krijojë mbështetjen ose kujdestarin e duhur.
2. Gjykata vendos mbi bazën e raportit të klerimit ('Clearing') nëse procedura do të vazhdojë. Nëse po, personi në fjalë ftohet në një séance (ndëgjim) të parë. Për procedurat e mëtejshme caktohet një këshilltar ligjor, i cili do të përfaqësojë interesat e individit në fjalë dhe do të ofrojë mbështetje. Në çështjet e urgjencës, një përfaqësues për të rritur (Erwachsenenvertreter) i përkohshëm do të emërohet për kohëzgjatjen e procedurës. Gjykata mund të udhëzojë një mjek për të bërë dhe paraqitur një ne ekspertizë, duke përcaktuar nëse aftësia vendimmarrëse e individit në fjalë është e kufizuar. Gjithashtu është e mundur që nga personi në fjalë të kërkohet që një ekspert të konsultohet.
3. Gjykata do të shqyrtojë të gjitha dëshmitë në dispozicion dhe mund të thërrasë një seancë dëgjimore për shqyrtim. Gjithashtu është e mundur të kërkohet një seancë e tillë dëgjimore nga vet personi. Procedura përfundon me një vendim (Aktvendim) në lidhje me atë nëse dhe deri në çfarë mase gjykata do të emërojë përfaqësim. Një gjykatë mund të emërojë vetëm një përfaqësues për çështjet aktuale. Këto duhet të përcaktohen saktësisht

Was ist ein Genehmigungsvorbehalt?

Personen mit einem gerichtlichen Erwachsenenvertreter oder einer gerichtlichen Erwachsenenvertreterin bleiben grundsätzlich in Rechtsgeschäften handlungsfähig. Vielleicht nimmt das Gericht aber an, dass sich eine Person durch ihr Verhalten ernstlich und erheblich schaden könnte. Dann kann bestimmt werden, dass bei Rechtsgeschäften oder Verfahrenshandlungen ausnahmsweise eine Zustimmung der gerichtlichen Erwachsenenvertreterin oder des gerichtlichen Erwachsenenvertreters einzuholen ist. Ohne deren/dessen Zustimmung ist die Handlung der vertretenen Person dann nicht gültig. Die Rechtsgeschäfte oder Verfahrenshandlungen, für die ein Genehmigungsvorbehalt ausgesprochen wird, müssen jedoch genau definiert und beschrieben werden.

Cila është miratimi i kushtëzuar?

Në rastet kur ekziston një përfaqësues i emëruar nga gjykata, individi në fjalë përgjithësisht mbetet i aftë të veprojë në transaksionet ligjore. Megjithatë, gjykata mund të supozojë se një person mund të dëmtohet rëndë dhe seriozisht nga vendimet e marra nga ai vet. Pastaj mund të përcaktohet se në raste të jashtëzakonshme, disa akte ligjore të ndërmarra nga personi i përfaqësuar nuk do të hyjnë në fuqi derisa të jenë miratuar nga përfaqësuesi i tyre i caktuar nga gjykata. Kështu, pa këtë miratim, akti bëhet i pavlefshëm. Megjithatë, aktet ligjore ose procedurale për të cilat kërkohet miratimi i tillë duhet të përcaktohen dhe përshkruhen me saktësi.

Cilat janë detyrat e një përfaqësuesi të caktuar nga gjykata?

Përfaqësuesi i caktuar nga gjykata duhet të ketë kontakt personal me klientin të paktën një herë në muaj. Klienti duhet të informohet në kohë për të gjitha vendimet e synuara në mënyrë që ai/ajo të kenë mundësinë të komentojnë (shprehet) mbi to. Ato komente duhet pastaj, në parim, gjithashtu të merren parasysh.

Së paku një herë në vit gjykata duhet të informohet me një raport mbi gjendjen jetësore të klientit si dhe sa shpesh dhe në çfarë mënyre kanë kontaktuar individi dhe përfaqësuesi i tij/saj. Gjithashtu, duhet të renditen veprimet specifike të përfaqësuesit brenda fushës së aplikimit. Kjo pastaj thekson se cilat çështje ende kërkojnë një përfaqësues. Nëse përfaqësuesi është gjithashtu përgjegjës për menaxhimin e të ardhurave dhe pasurive, duhet të hartohet një llogari e kujdesit. Kjo mund të thjeshtohet në rastet kur një përfaqësues është gjithashtu një i afërm. Vendime veçanërisht të rëndësishme (të tilla si lëvizja në një shtëpi pleqsh ose shitja e një prone) duhet ti nënshtrohen aprovimit të gjykatës.

Kur përfundon një përfaqësim i emëruar nga gjykata?

- kur gjykata e përfundon atë (p.sh. nëse çështja është zgjidhur ose eliminimi I parakushteve).
- pas tre vjetësh (por mund të rinovohet në një procedurë të veçantë).
- nëse personi i përfaqësuar vdes.

Sa kushton përfaqësimi ligjor i të rriturve?

Përfaqësuesi mund të aplikojë në gjykatë për kompensimin dhe rimbursimin e shpenzimeve (p.sh. shpenzimet e udhëtimit, telefonit dhe postës). Si kompensim zakonisht merren 5% të të ardhurave neto të personit të përfaqësuar. Të ardhurat specifike të tilla si ndihma për kujdesin, ndihmat familjare dhe ndihmat për strehim (Pflegegeld, Familien- und Wohnbeihilfe) nuk mund të përfshihen në llogaritjen. Nëse pasuria e personit të përfaqësuar tejkalon shumen prej 15 000 euro, përfaqësuesi i të rriturve mund të aplikojë për 2% të tyre (pas zbritjes ese shumës bazë prej 15 000 euro). Shuma aktuale e kompensimit do të vendoset nga gjykata.

Deri më tani, një kujdestar ka marrë përsipër punët e mia ose punët e një personi të afërt me mua. Çfarë ndodh tani sipas ligjit të ri?

Të gjitha kujdestarët transferohen automatikisht në përfaqësitë e emëruara nga gjykata, kujdestarët bëhen përfaqësues të caktuar nga gjykata. Që nga 1 janari 2024, të gjitha kujdestarët e transferuara skadojnë nëse procedurat e përtëritjes gjyqësore nuk janë iniciuar. Kërkesa staturore për miratim (miratimi i kushtëzuar) zbatohet deri më 30 qershor 2019 për të gjithë individët të cilëve u është caktuar kujdestari para 1 korrikut 2018.

Në çdo kohë, personat e përfaqësuar mund të kërkojnë anulimin e përfaqësimit ligjor të të rriturve ose rezervimin e miratimit (miratimit të kushtëzuar). Gjithashtu, mund të kerkohet kalimi në një formë tjetër përfaqësimi (të zgjedhur ose përfaqësim statutor të të rriturve). Jemi të lumtur t'ju këshillojmë.

Informacione të mëtejshme dhe detajet e kontaktit

Detajet e kontaktit dhe informacione të tjera mund të gjenden në faqen tonë të internetit:

www.vertretungsnetz.at